

## Znj. Anila Dedaj

GAZETARE, TV "ABC" - Emisioni "VETTING"

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, drejtuar ISSH-së, nëpërmjet e-mailit zyrtar, në dt: 4.05.2021, ju sqarojmë si në vijim:

Në lidhje me pyetjen: *Sa i përket Ligjit nr.8/2017 " Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit", kur nisi të zbatohet nga ISSH dhe sa punonjës përfituan prej tij? Për sa kohë u zbatua i plotë (para ndryshimeve të Ligjit nr. 29.2019)?*

Në zbatim të ligjit 8/2017, VKM nr.425 datë 10.05.2017 si dhe Udhëzimit të ISSH nr.6711 datë 01.08.2017, strukturat rajonale të sigurimeve shoqërore filluan punën për plotësimin e dokumentacionit dhe përcjelljen sipas rastit në adresë të Komisionit të posaçëm pranë Ministrisë së Energjitikës dhe Industrisë apo në adresë të kërkuesit, për çdo aplikant. Në strukturat e sigurimeve shoqërore janë depozituar rreth 9,628 kërkesa për përfitim sipas ligjit nr.8/2017. Por, me ligjin 8/2017 nuk u caktua asnjë përfitim, për arsye se nuk u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në të cilën do të përcaktohen procedurat e caktimit të pensionit dhe shtesës mbi pension, efektet financiare dhe burimet e financimit të tyre në shtesë të buxhetit të ISSH-së.

Në lidhje me pyetjen: *Po prej Ligjit nr. 29/2019 "Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji" sa punonjës bënë kërkesë dhe sa përfitojnë?*

Konform ligjit 29/2019 "Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", kanë **aplikuar 32.800 persona** dhe kanë **përfituar 23.411 persona**.

Në lidhje me pyetjen: *A mund të na veçoni sa prej tyre janë punonjës të industrisë së naftës e gazit dhe sa punonjës të metalurgjisë që aktualisht marrin trajtimin financiar suplementar?*

Në zbatim të ligjit 29/2019, punonjës të industrisë së naftës dhe gazit janë **8.270 përfitues** dhe punonjës të metalurgjisë janë **1.695 përfitues**.

Në lidhje me pyetjen: *Nëse është e mundur do të donim të dinim me shfuqizimin e Ligjit nr.8/2017 në pikën 1 të nenit 2; nenet 9, 10, 11 e 12; pika 1, e nenit 13, dhe nenet 14 e 15, cila është vlera që i kursehet Buxhetit të Shtetit?*

Ligji 29/2019, në nenin 11 të tij "Të drejtat e njohura" përcakton: *Në ligjin nr. 8/2017, "Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit", pika 1, e nenit 2; nenet 9, 10, 11 e 12; pika 1, e nenit 13, dhe nenet 14 e 15 shfuqizohen.*

Shfuqizimi i ligjit 8/2017, dhe miratimi i ligjit 29/2019 zgjeroi numrin e përfituesve pasi në ligjin 29/2019 u përfshinë edhe punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë, si dhe punonjësit e metalurgjisë, të cilët nuk ishin parashikuar në ligjin 8/2017.